

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE,
NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL
NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE**

Drejtor i Drejtorisë së Integritit, Analizës dhe Monitorimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Juridike dhe Integritit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shpall procedurat e lëvizjes paralele, të ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil për pozicionin:

1 (një) Drejtor i Drejtorisë së Integritit, Analizës dhe Monitorimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Juridike dhe Integritit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - klasa e pagës II-1.

Pozicioni më sipër, i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil.

PËR TË TRE PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

11/04/2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

NGRITJE NË DETYRË

16/04/2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

16/04/2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- a. Monitoron përgatitjen e raporteve në kuadër të progres-raportit të integritetit evropian, dokumenteve strategjike ku ILD, është institucion përgjegjës apo kontribues, si dhe çdo dokument tjetër që kërkon të dhëna mbi veprimtarinë e përgjithshme për angazhimet e marra, në kuadër të procesit të integritetit evropian;
- b. Monitoron punën për hartimin e metodologjisë për kërkime në kuadër të raportimeve dhe analizave periodike ligjore por edhe në përcaktimin e metodologjisë së inspektimeve, duke u mbështetur edhe në ekspertizën e ngjashme të vendeve apo institucioneve të tjera të ngjashme me Zyrën e ILD -së;
- c. Monitoron punën për përgatitjen e analizave për të gjitha projektvendimet e miratuara nga ILD, projekt vendimet e kthyera si dhe projektvendimet e ndryshuara nga ILD;
- d. Monitoron procesin e planifikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve studimore dhe kërkimore në kuadër të përmirësimit të proceseve analizuese dhe raportuese të lidhura me veprimtarinë dhe angazhimet e institucionit;
- e. Monitoron dhe ndjek zbatimin e rekomandimit të lëna, në raportet e inspektimit ligjor tematik dhe institucional, duke paraqitur raporte për kryetarin grupit të inspektimit, me qëllim vlerësimin nëse qëllimi i rekomandimit është përmbushur.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë II;
- b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) Të kenë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në profesion;
- c) Të kenë njohuri të gjuhës angleze.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
- d) Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- h) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore, në linkun: <https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- i) Vlerësimin e fundit nga eprori;
- j) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- k) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, brenda datës **11/04/2026**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s’kualifikim të kandidatit.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **14/04/2026**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr.97/2016 “Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele Brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje Brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimit, nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut të institucionit. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

2

NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se, pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se, është ende pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Këtë informacion do ta merrni në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit për publikun të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data 27/04/2026.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë III;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) Të kenë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në profesion;
- c) Të kenë njohuri të gjuhës angleze.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
- d) Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- h) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore në linkun: <https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- i) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- j) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- k) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, brenda datës **16/04/2026**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s’kualifikim të kandidatit.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **27/04/2026**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe standat e informimit të publikut të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes ne detyre dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, , për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, I ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr.97/2016 “Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimit për Ngritje në Detyrë brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut të institucionit. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit të publikut të institucionit, për fazat e mëtejshme:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit për publikun të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data: **27/04/2026**.*

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se, është pozicioni vakante, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

Kjo procedurë është vendosur të jetë e hapur edhe për kandidatët të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira, neni 26/4 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Këtë informacion do ta merrni në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit për publikun të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data 27/04/2026.

3.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT NË PROCEDURËN E PRANIMIT NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.*
- b) Të kenë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në profesion.
- c) Të kenë njohuri të gjuhës angleze.

3.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- c) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
- d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- g) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore në linkun:
<https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- h) Vërtetim nga gjykata;
- i) Vërtetim nga prokuroria;
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, brenda datës **16.04.2026**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s’kualifikim të kandidatit.

3.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **27.04.2026**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

3.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, I ndryshuar;

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr.97/2016 “Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përkrahimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

3.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

3.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimi për Ngritje në Detyrë brenda **3** ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit të publikut të institucionit, për fazat e mëtejshme:

- *për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;*
- *datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi*

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit për publikun të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data: **27/04/2026**.*